



## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Për Aktivitetin e Prokurimit: 328-19-7136-1-2-1

Sa i përket tenderit për: Furnizimi dhe montimi Klimave për SKGjK dhe Gjykata

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

ALFA.I SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ibrahim Rugova pn.

(Adresa)

Lipjan

14 000

(Vendi)

(Kodi postar)

00383 38 606 706

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Lulzim JAHAJ

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@alfa-i.com

(Adresa elektronike)

07.02.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)



## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Njoftimi për Kontratë: 20.09.2019  
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 14.10.2019 13:30  
Fillimi i procesit për Hapjen e Tenderëve: 14.10.2019 13:30  
Njoftimi mbi vendimin e AK nr. 1:25.10.2019  
Njoftimi mbi vendimin e AK nr. 2:24.01.2020  
Kërkesa për rishqyrtim dt:29.01.2020  
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt:31.01.2020

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

Dosja është dorëzuar me ane të platformës elektronike të prokurimit, procesverbalin e hapjes e kemi pranuar nga ajo platforme.

##### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

##### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

##### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 60 i LPP-së  
Neni 64 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

##### 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt.24.01.2020, ku kanë rekomanduar për kontratë OE "As Tech", ndërsa neve na ka shpallur si tenderues i pasuksesshëm me arsyetimin se nuk e kemi dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët.

Si fillim ju sqarojmë se AK-ja e ka rekomanduar për kontratë OE i cili është, i papërgjegjshëm sepse siç e dini në vendimin e kaluar të AK-së të dt.25.10.2019 e kanë shpallur OE në fjalë si tenderues të eliminuar, pasi që nuk ka sjellur katalogjet për produkte të cilat i ka ofruar. Edhe pse AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë përsëri sqarime e ofruara nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe e ka refuzuar tenderin e këtij operatori ekonomik.





Por edhe pse AK-ja ka refuzuar tenderin e OE të lartpërmendur, sepse nuk ka ofruar shpjegime të mjaftueshme për sqarimet e kërkuara, pas kërkesës për rishqyrtim të këtij operatori të cilën AK-ja e ka refuzuar, OSHP e ka kthyer lëndën në rivlerësim, ndërsa pas rivlerësimit edhe pse ky OE është i papërgjegjshëm AK-ja e ka shpallur fitues.

Gjithashtu ju sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit është ri-tenderim, ndërsa herën e parë është anuluar ky aktivitet i prokurimit për arsye se asnjë OE nuk ka sjellur katalogjet me specifikat e kërkuara ne dosje te tenderit, sepse autoritetin kontraktues e ka cekur se nuk pranohen variantet.

Të nderuar AK-ja ka rënë në kundërshtim me vendimin e saj pasi që tani ka rekomanduar për kontratë OE i cili për projektin e njëjtë ka ofruar klima me variante, sepse në specifikimet teknike është kërkuar "Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ulët -7°C, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar klima me specifika tjera, klima ku sistemi i ngrohjes funksionon edhe nëse temperatura e jashtme e kohës është e ulët -15-30°C ne specifikimet e detajuara, kurse ne faqen e parë ne përshkrimin gjeneral te produktit shkruhet -20°C . (gjeni te bashkangjitur katalogun me specifikime gjenerale dhe detale te ofruar nga OE i rekomanduar për kontrate). Ju njoftojmë qe në njoftimin për kontratë dhe ne dosje të tenderit

**VARIANTET NUK PRANOHEN.**

Ju sqarojmë se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, i njëjti ka ofertuar me prodhuesit BRUNO, ARIELLI dhe MAX dhe ne deklaratën e tij me datë 20.01.2020 deklaroi se keni katalogjet për modelet BRUNO dhe MAX, kurse për modelin ARIELLI ka dërguar një link.

Fillimisht ju njoftojmë që katalogu i dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk mund të gjindet askund në faqet zyrtare të prodhuesit, pra ka dyshime që ky katalog është fiktiv, ju lusim juve Ta detyroni Autoritetin Kontraktues të verifikoj këtë katalog. Gjithashtu ka diskrepancë për arsye se emrat e klimave janë të titulluara si Klima ON/OFF (shembull WALL MOUNTED ON/OFF) ndërsa specifikimet i kanë sjellur për INVERTERA e jo për klima.

Po ashtu linku i dërguar me datë 20.01.2020 për prodhuesin ARIELLI është link për klimat 9000 BTU, ndërsa tck përshkrimi i çmimeve OE i rekomanduar për kontratë ka deklaruar që me këtë prodhues do të ofroj klima 12000 BTU.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse AK-ja ka kërkuar klima muri, ndërsa OE i rekomanduar për klimën 24000 Btu ka ofertuar me klimë dyshemeje (floor standing on/off), pra OE në fjalë nuk e ka përmbushur as këtë kërkesë dhe duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

AK-ja na ka diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm.

Ne me dt. 31.01.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1.1.1 LPP-së.



Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

### V E N D I M

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE ALFA.I SH.P.K.

**ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**,

**DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

